REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2018:031583
Datë:	01.03.2019
Numri i dokumentit:	00236815

P.nr.1030/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.A, nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren, PP/II.n.r.777-67/18 të datës 25.06.2018, pas mbajtjes së seancës fillestar publike në pranin e Prokurorit të shtetit në Prizren Fatos Ajvazi, të akuzuarit, me datë 15.01.2019, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.A, nga i ati I. dhe nëna Sh. e lindur B., i lindur me datë ... në Prizren, ku edhe tani jeton "...", nr.51, ka të kryer shkollën fillore, punëtor i martuar, baba i ... fëmiut, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTE FAJTOR

Me datë 15.05.2017 rreth orës 21,30 minuta në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, gjatë kontrollimit në automjetin "..." me targa të regjistrimit ..., në ulësen e prapme të automjetit është gjetur një qese plastike, substancë narkotike me pesh rreth 1,6 gram, substancë të llojit marihuan (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC),

Këso dore ka kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.2 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të neni 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 275 par.2 të KP-ës, të akuzuarit i shqipton.

DËNIM ME KUSHT

2018:031584

Vërteton dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afatj prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 10 (dhjetë) ditë burg.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Konfiskohet substanca narkotike me peshë të përgjithshme 1,6 gram,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.n.r.777-67/18 të datës 25.06.2018, kundër të akuzuarit B.A nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP/II.n.r.777-67/18 të datës 25.06.2018, kundër të akuzuarit B.A, nga Prizreni, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari B.A, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, është e vërtet gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës që në ditën, kohën dhe vendin e cekur si në të njëjtën, jam hasur nga ana e zyrtarëve policor duke drejtuar automjetin e markës "...", me targa të regjistrimit ..., dhe me rastin e kontrollimit të njëjtit kanë hasur një qese të plastikës, në të cilën ka qenë një sasi e marihuanës në peshë prej 1,6 gram, dhe kjo sasi ka qenë e imja personale, në kohën kur ka ndodhur rasti kam përdorur substanca narkotike, por tani e kam ndërprerë dhe jam larguar nga përdorimi i tyre, ngase kam krijuar familje, jam baba i një fëmiut, andaj të cekurat më lart, rrethanat e mija personale, moshën time, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, rrethanat e mija familjare që jam person familjar, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

2018:031584

Me datë 15.05.2017 rreth orës 21,30 minuta në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, i akuzuari, gjatë kontrollimit në automjetin "..." me targa të regjistrimit ..., në ulësen e prapme të automjetit është gjetur një qese plastike, substancë narkotike me pesh rreth 1,6 gram, substancë të llojit marihuan (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC),

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cilli në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat e propozuara. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se egziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë , për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope nga neni 275 par.2 të KP-së, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti i cili denim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjsinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, e duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti i cili denim nuk do të ekzekutohet në afat të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, si dhe dënimin me gjobë në lartësi prej 200 (dyqind) euro, sepse konsideron se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimin mbi konfiskimin e sendit gjykata e bazoi në kuptim te nenit 115 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1030/2018 me datë 15.01.2019

Procesmbjatesja **Gjyqtari,**
Nacis Sarani **Luan Berisha**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,gjykatës së apelit në Prishtinë,nëpërmjet kësaj gjykate.

2018:031584